

1. Titulli i lëndës: HULUMTIM NË ÇRREGULLIMIN E PËRMBAJTJES MEDIALE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Hulumtim në çrregullimin e përmbajtjes mediale
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i II-të , Semestri i III-të
Numri i orëve në javë:	2 +2
Kreditë ECTS:	5
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Mësimdhënësi: Dr. Dren Gërguri
Të dhënat kontaktuese:	dren.gerguri@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë fokusohet në çrregullimin e përmbajtjes mediale (informative), një koncept kyç për të kuptuar sfidat moderne të gazetarisë dhe komunikimit publik. Lënda trajton konceptet themelore si dezinformimi, keqinformimi dhe informacioni i dëmshëm, duke analizuar format, qëllimet dhe efektet e tyre në demokraci, opinion publik dhe gazetari. Studentët do të njihen me teoritë kryesore, qasjet metodologjike dhe analizat empirike të përdorura në hulumtimet e çrregullimit të informacionit.
Qëllimet e lëndës:	- T'i pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike mbi çrregullimin e përmbajtjes mediale. - T'i zhvillojë aftësitë e tyre për të hulumtuar, analizuar dhe identifikuar forma të ndryshme të përmbajtjes së rreme ose manipuluese. - Të nxisë mendimin kritik dhe etikën profesionale në trajtimin e informacionit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Në përfundim të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të: - Dallojnë format e ndryshme të çrregullimit të përmbajtjes mediale; - Përdorin metoda të hulumtimit për analizimin e përmbajtjes problematike; - Vlerësojnë ndikimin e dezinformimit në opinionin publik dhe proceset demokratike; - Hartojnë projekte hulumtuese mbi përmbajtjen e

		rreme në media.	
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2 (90min)	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	30
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	5	2	10
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit			
Detyrë shtëpie	1	10	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja për provimin final	7	3	21
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
Total			129.5 orë
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata interaktive, analiza rastesh, diskutime në grup, detyra praktike, projekte hulumtuese.		
Metodat e vlerësimit:	10% Pjesëmarrja 15 % Test intermediar 30% Ushtimet 45% Provimi final		
Literatura primare:	- Wardle, C., & Derakhshan, H. (2017). <i>Information Disorder: Toward an interdisciplinary framework</i>. Council of Europe. - Gërguri, D. (2023). <i>Çrregullimi informativ në epokën digjitale</i>. Dukagjini. - Tandoc, E. C., Lim, Z. W., & Ling, R. (2018). <i>Defining “Fake News”: A typology of scholarly definitions</i>. Digital Journalism. - Marwick, A., & Lewis, R. (2017). <i>Media manipulation and disinformation online</i>. Data & Society.		
Literatura shtesë:	• Silverman, C. (Ed.). (2015). <i>Verification Handbook</i>. European Journalism Centre. • McQuail, D. (2010). <i>McQuail’s Mass Communication Theory</i>. Sage. • Flynn, D. J., Nyhan, B., & Reifler, J. (2017). <i>The Nature and Origins of Misperceptions</i>. Political Psychology.		

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1	Çrregullimi i përmbajtjes mediale: konceptet themelore
Java 2	Kategoritë e çrregullimit informative
Java 3	Teoritë e informacionit të rremë
Java 4	Motivimet prapa prodhuesve të përmbajtjes së rreme
Java 5	Roli i algoritmeve dhe platformave sociale
Java 6	Efekti i çrregullimit në opinionin publik
Java 7	Metodologji për hulumtim të përmbajtjes mediale
Java 8	Analiza e rasteve: shembuj lokalë dhe globalë
Java 9	Java e testit intermediar
Java 10	Mjetet digjitale për verifikim të fakteve
Java 11	Edukimi medial si kundërpërgjigje
Java 12	Politikat publike dhe rregullimi i përmbajtjes
Java 13	Prezantimi i punimeve hulumtuese
Java 14	Diskutim për etikën në raportim
Java 15	Përmbledhje dhe përgatitje për provim
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes	
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: Zbatohen politikat dhe rregullat e përgjithshme të Fakultetit të Filologjisë për integritetin akademik dhe sjelljen e studentëve.	